

M. 6835/ Prot  
dt. 16.12.21



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr.802/1 prot.

Shkodër, më 13.12.2021

**LËNDA: Mbi vendimin Nr. 65, datë 26.11.2021 të Këshillit Bashkiak Vau-Dejës.**

**KESHILLIT BASHKIAK VAU-DEJËS**

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji Nr.107/2016 dt.2.10.2016 “Për Prefektin”, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175 dt.9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe aneksi 1 “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, Kreu II, neni 4, Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 23, 26, 27, 29, neni 55/3, neni 64/c, ligjit Nr.10279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative” neni 6 germa b, neni 7 germa ç, neni 10, pika 3, neni 20, ligjit nr.8224 datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë bashkiake” i ndryshuar, VKM Nr.1096, datë 28.12.2015 “Per miratimin e rregullave, kushtave e procedurave për perdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”, neni 1, materialit të depozituar nga Sekretari i Këshillit Bashkiak Vau-Dejës Nr.6831prot datë 2.12.2021 “Mbi dërgimin e dokumentacionit shoqërues të mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau-Dejës me dat.26.11.2021”, *analizoi VKB Vau-Dejës nr.65 datë 26.11.2021* “Mbi miratimin e vendosjes së gjobave, për shkeljet që përbëjnë kundravajtje administrative për vitin 2022 në Bashkinë Vau-Dejës”.

Pas shqyrtimit, Prefekti konstaton se përmbajtja e këtij vendimi është e njëjtë me VKB nr.72 datë 26.11.2020 “Për miratimin e vendosjes së gjobave për shkeljet që përbëjnë kundravajtje administrative për vitin 2021, në Bashkinë Vau-Dejës”, për të cilin janë zhvilluar edhe seanca konsultimi. Vërehet se është bërë një shtesë të Kap IV “Hedhje e mbeturinave bujqesore si (degë pemë, gjethe, shkurre etj) me vlere 20.000 leke, por për të cilën duhet të zhvillohen seanca konsultimi, referuar nenit 18, neni 54/k të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar dhe ligjit Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”,  
Dukë ju falenderuar për bashkëpunimin.

**P R E F E K T I**

**Majlinda ANGONI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**BASHKIA VAU DEJËS  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr. 65 datë 26.11. 2021

**“Miratimin e vendosjes se gjobave, per shkeljet qe perbejne kundravajtje administrative,  
per vitin 2022, ne Bashkine Vau-dejes”**

Mbështetur ne Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjin nr. 10279, date 20.05.2010 “Per kundravajtjet administrative”, i neni 6, pika b, neni 10, pika,3, Ligji Nr. 10433, date 16.6.2011 “Per inspektimin ne Republiken e Shqiperise”ligji Nr. 8224, date 15.5.1997 “Per organizimin dhe funksionimin e policise bashkiake”, i ndryshuar, I propozojme keshillit bashkise te

**KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D O S I:**

**1. “Miratimin e vendosjes se gjobave, per shkeljet qe perbejne kundravajtje administrative,  
per vitin 2022, ne Bashkine Vau-dejes”, bashkelidhur tabela.**

2. Efektet fillojne shtrihen nga 01.01.2022 deri me 31.12.2022

3. Ngarkohen Sektori Ardhurave, Bashkia Vau-dejes.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite me shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”)

**K R Y E T A R**

Mark Bisha

Sekretari i Këshillit BashkiaK

Ardian Çelepija

Miraturar me 19 vota

Vota Pro 19

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 02.12.2021



**LLOJET DHE NIVELET E GJOBAVE, PER SHKELJET, QE PERBEJNE KUNDRAVAJTJE ADMINISTRATIVE, TE PERCAKTUARA SIPAS PROBLEMATIKAVE NE TERRITORIN E BASHKISE VAU-DEJES, DHE QE DO TË VENDOSEN NGA POLICIA BASHKIAKE, JANE SI ME POSHTE:**

Këshilli Bashkise Vau-Dejes ka drejte te vendose dhe te miratoje, llojet e gjobave dhe nivelin e tyre per vitin 2022, deri në masën 20,000 lekë.

<b>Nr</b>	<b>Lloji i gjobave</b>	<b>Niveli i gjobës Viti 2021</b>
<b>I</b>	<b>Niveli i gjobave për kryerjen e aktivitetit tregtar pa license, autorizim apo leje përkatëse të jetë si më poshtë:</b>	
<b>I.1</b>	<b>Mospajisja me license, autorizim apo leje përkatëse transporti</b>	
➤	Motokarro.	2.000
➤	Transport udhëtaresh me taksi 4+1	10.000
➤	Transport udhëtaresh me taksi 8+1	15.000
➤	Mjete të tonazhit të lartë.	20.000
➤	Hyrje pa autorizim në rrugët kryesore të qytetit për mjetet e tonazhit të lartë.	15.000
<b>I.2</b>	<b>Mospajisja me leje tregtimi me pakicë të karburanteve dhe njësive të shitjes së lëndëve djegëse dhe bombulave të gazit.</b>	10.000
<b>I.3</b>	<b>Mospajisja me leje për shërbim me tavolinë jashtë lokalit.</b>	5.000
<b>I.4</b>	<b>Mospajisja me leje për ushtrim aktiviteti "24 orësh".</b>	10.000
<b>I.5</b>	<b>Mospajisja me leje për zënie të hapësirës publike.</b>	
➤	Ekspozim malli.	10.000
➤	Veprimtari që do të zhvillohen në hapësirat publike.	5.000
<b>II.</b>	<b>Niveli I gjobave per mos respektim i rregullave të qarkullimit të jetë si me poshtë:</b>	
➤	Parkim të gabuar të mjetit.	1.000
➤	Zënie trotuari.	20.000
➤	Qarkullim i mjetit duke shkelur rregullat e qarkullimit (Sinjalistikes).	2.000
<b>III.</b>	<b>Niveli i gjobave për dëmtim dhe ndërhyrje në infrastrukturen rrugore të jetë si më poshtë:</b>	
➤	Dëmtim rruge.	20.000
➤	Çarje rruge.	20.000
➤	Zënie rruge.	10.000
➤	Dëmtim bordure.	10.000
➤	Dëmtim trotuari.	10.000
➤	Çarje trotuari	20.000
➤	Zënie trotuari (inerte. material etj) nga biznese.	15.000
➤	Zënie rruge dhe trotuari (ambulantë e familjarë).	2.000
➤	Dëmtim, bllokim, vjedhje pusetash.	10.000



<b>IV.</b>	<b>Niveli I gjobave per ndotje të rrugëve.</b>	
➤	Persona juridik.	20.000
➤	Persona fizik.	10.000
➤	Qytetarë.	2.000
➤	Hedhja e inerteve në vende të pamiratuara nga biznese.	20.000
➤	Hedhja e inerteve në vende të pamiratuara nga familjere.	10.000
➤	Hedhje e mbetjeve urbane në rrugë, trotuar, në hapësirën publike, jashtë vendeve të përcaktuara nga familjaret.	10.000
➤	Hedhje e mbetjeve urbane në rrugë, trotuar, në hapësirën publike, jashtë vendeve të përcaktuara nga biznesi.	20.000
➤	Hedhje e mbeturinave bujqesore si (dege pemesh, gjethe, shkurre, etj)	20.000
➤	Dëmtim kosha mbeturinash.	20.000
➤	Dëmtim stola pushimi.	10.000
<b>V.</b>	<b>Niveli i gjobave për dëmtimet dhe ndërhyrjet në rrjetin e ndiçimit rrugor të jetë si më poshtë:</b>	
➤	Lidhje e pa miratuar në rrjetin rrugor.	20.000
➤	Dëmtim të shtyllave të ndiçimit.	20.000
➤	Dëmtim i ndiçuesve.	20.000
➤	Përdorimi i shtyllave të ndiçimit si suport për montimin e reklamave, kapjen e kablllove etj.	10.000
➤	Dëmtim i traseve, kablllove dhe linjave ajrore nga punimet që kryhen prane tyre me leje dhe pa leje si dhe shkulja e shtyllave.	20.000
➤	Ndërhyrje në kuadrot elektrik public.	10.000
<b>VII.</b>	<b>Niveli i gjobave për ndërhyrje dhe demtime në hapësirat e gjelbërta dhe publike të jetë si më poshtë:</b>	
➤	Dëmtim i hapësirave publike të gjelbërta.	20.000
➤	Dëmtim. prerje e pemëve.	20.000
➤	Zënie e hapësirave publike të gjelbërta pa leje.	20.000
➤	Vendosje tabelash, pankartash, banderola pa leje.	5.000
➤	Vendosje postera pa leje.	5.000
➤	Mos ndertim i bazamenteve te konteniereve te mbetjeve urbane te subjekteve te ndertimit per objektet me 5 kate.	20.000



SEKRETARI KESHILLIT

Ardian CELEPIJA

KRYETARI I KESHILLIT

Mark BISHA